



KRYETARI I KOMUNËS

01-Nr-465 016-12540 Datë 19.02.2021

Në bazë të nenit 4 pika 2 dhe 2.4, 3.3 nenit 8 pika 5 , të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshimet dhe plotësime e bëra me Ligjin Nr-03/L-205, dhe nenit 13 , 82, 109 të LPA-së nr-02/L-28, si dhe Aktvendimit C nr.412/18 të Gjykatës Themelore Prizren-Dega në Suharekë me të cilën aprovohet propozimi i paditësit që vlerësimi i pronës së shpronësuar për interes publik dhe për zgjerimin e rrugës në ZK. Suharekë, ta bëjë Departamenti për shpronësim në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa në Prishtinë. Kryetari I Komunës së Suharekës , merr këtë :

V E N D I M

(Për pranim formal të kërkesës për shpronësimin e paluajtshmerisë)

-MIRATOHET pranimi formal i kërkesës për shqyrtim të mëtejshme lidhur me shpronësimin e pronës së paluajtshme, për interes publik dhe për zgjerimin e rrugës në ZK. Suharekë të precizuar si në hyrje të këtij Vendimi, për ngastrën kadastrale me nr.P-72116046-**01453-30** në sip prej: **24 m²** me kulturë arë në vendin e quajtur “Rezina”, evidentuar në emër të Muharem (Shaban) Kuqi, ZK. Suharekë.

- Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e vacantë për vlerësimin e pronës së paluajtshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr-03/L-205 për zbatimin e metodeve dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

-Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër .

- Ky Vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

Iu dërgohet:

Subjektit kërkues;

Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe

Arkivit.

